



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1451/24 Datë: 23.07.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Akademisë Tempulli për periudhën **tre (3)** vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Sigurimet, Menaxhimi dhe Inovacioni Bachelor Profesional 180 ECTS (me 3 specializime)*
1.Menaxhimi dhe Vlerësimi I dëmeve, 2. Ndërmarrësia dhe Inovacioni, 3.Sistemet inteligjente në transport dhe logjistikë, **me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;**
- II. Riakreditohet programi i studimit i Akademisë Tempulli për periudhën **pesë (5)** vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit Bachelor Profesional 180 ECTS (me 3 specializime),*
1.Trafiku dhe Transporti Rrugor, 2.Trafiku dhe Transporti Hekurudhor, 3. Planifikimi dhe Lëvizshmëria Urbane-mobiliteti i mençur, **me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;**
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Akademia Tempulli që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Akademia Tempulli të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Akademia Tempulli brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Sigurimet, Menaxhimi dhe Inovacioni Bachelor Profesional 180 ECTS A (me 3 specializime) 1.Menaxhimi dhe Vlerësimi I dëmeve, 2. Ndërmarrësia dhe Inovacioni, 3.Sistemet inteligjente në transport dhe logjistikë</i>	Ema Berisha Krasniqi Fatbardh Xhaferi Shpresa Ibrahim Adem Selmani Arsim Azemi
2.	<i>Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit Bachelor Profesional 180 ECTS (me 3 specializime), R 1.Trafiku dhe Transporti Rrugor, 2.Trafiku dhe Transporti Hekurudhor, 3. Planifikimi dhe Lëvizshmëria Urbane-mobiliteti i mençur.</i>	Mevlan Bixhaku Muhamed Krasniqi Fitim Shala Astrit Sallauka Eflorim Hajra

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Akademinë Tempulli, me ekipin e ekspertëve: *Magdalena Platis, Tauno Otto dhe Christopher Bohlens*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Sigurimet, Menaxhimi dhe Inovacioni Bachelor Profesional 180 ECTS (me 3 specializime)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Magdalena Platis, Tauno Otto dhe Christopher Bohlens është organizuar më 24.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; *Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit Bachelor Profesional 180 ECTS (me 3 specializime)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Tauno Otto, Magdalena Platis, dhe Christopher Bohlens është organizuar më 24.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 125-të, të mbajtur më datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Akademisë Tempulli dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.


Prof. Asoc. Dr. Hashija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.